

## Fleta udhëzuese Nxitja e hershme e gjuhës Së bashku për fëmijën

Nxitja e gjuhës është një shenjë cilësie në institucionet parashkollore, sepse çdo fëmijë mund të fitojë individualisht nga një mjedis nxitës gjuhor. Nëse hyjmë në bisedë me fëmijën, e nxisim atë për tregimin, dëgjimin, përdorimin e fantazisë, parashtrimin e pyetjeve dhe për arsyetimin, atëherë japim një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin e tij gjuhor.

### **Si mund ta përkrahni ju si prindër fëmijën tuaj në jetën e përditshme?**

Thelbi i nxitjes së gjuhës në jetën e përditshme është të qëndroni në dialog me fëmijën tuaj. Përmes interesimit dhe parashtrimit të pyetjeve zgjerohet fjalori duke lozur. Fëmijët në moshën parashkollore janë si «thithës pluhur për fjalë». Në vitet e para të jetës, ata kanë aftësinë t'i mbajnë drejtpërsëdrejti në mend fjalë të reja tashme me dëgjimin e parë të tyre. Megjithatë kështu ata ende nuk dinë, se ç' kuptim ka fjala tamam dhe sesi ajo përdoret saktësisht. Prandaj atyre u nevojitet, që ata përjetojnë terma të reja herë pas here në situata të ndryshme. Vetëm me kalimin e kohës, ata pastaj mund t'i përdorin ato vetë qëllimisht.

Në jetën e përditshme, ju mund të hyni në një bisedë me fëmijën tuaj në kuadër të veprimeve të zakonshme dhe të situatave të përtërira. Sidomos këto situata të përditshme përmbajnë shanset për përsëritjet e rëndësishme. Kështu fëmija herë pas here i dëgjon termat e njëjta. Për këtë gjë nuk nevojitet as planifikim dhe as përgatitje, vetëm një të qenit i vetëdijshëm për rëndësinë e këtyre situatave dhe kujdesi t'i kuptoni dhe t'i shfrytëzoni ato.

### **Bashkërisht të lozni dhe të tregoni rrëfenje**

Edhe të lozesh e nxit mësimin gjuhor. Gjatë kësaj, fëmija përsërit duke lozur përjetimet nga bota e jetesës së tij dhe hyn në botën e vet të fantazisë. Zhvillimi i gjuhës dhe zhvillimi i lojës kanë një lidhje të ngushtë me njëri tjetrin. Fëmija e zoton këtë dhunti, që të lozë thjesht nga fantazia e vet, por edhe materiali i ri dhe tërheqës mund të zgjojë kureshtjen e tij. Nëse ju si person i rritur bashkoheni me lojën e fëmijës, ju mund të shprehni ngjarjet me fjalë dhe t'i formoni ato në gjuhë. Kështu bëheni një shembull për gjuhën, duke e futur veten në lojë dhe duke u futur në këtë dialog të rëndësishëm.

Libri me vizatime gjithashtu mund të përdoret qëllimisht për nxitjen e gjuhës. Ka një efekt të posaçëm nxitës, nëse ju ta mos thjesht lexoni ose tregoni atë, por nëse e përfshini fëmijën tuaj. Kësisoj synohet, që edhe ai të kontribuojë idetë e veta në zhvillimin e historisë dhe të zhvillojë më tej mendimet e veta. Ju nga ana tjetër i përsëritni shprehjet e gabuara të fëmijës tuaj në mënyrën e saktë dhe plotësoni edhe fjali të paplota. **Me rëndësi:** Mos i përmendni gjatë këtij veprimi gabimet shprehimisht, por i tregoni fëmijës tuaj, që ju e keni kuptuar atë. Fëmija juaj këssoj korrigjohet në mënyrë indirekte dhe e dëgjon gjënë më të rëndësishme, pra sesi shprehja thuhet saktësisht.

### **Ç' gjuhë është më e rëndësishmja?**

Nganjëherë prindër duan ta ndihmojnë fëmijën e vet duke folur vetë gjermanisht në vend të gjuhës së tyre të zemrës. Megjithatë ne duam t'ju mbështesim në këtë gjë, që fëmija juaj ta mësojë gjuhën e tij të parë me themel. Hulumtimi për mësimin e gjuhës së dytë tregon qartësisht, që prindërit e ndihmojnë fëmijën e vet më mirë, nëse ata vazhdojnë të flasin gjuhën e vet me atë. Sepse sa më mirë fëmija flet gjuhën e tij të parë, sa më lehtë ai do të mësojë edhe një gjuhë tjetër si shtesë.

Institucione të kujdesisë parashkollore janë një vend ideal, ku fëmijë tashme përpara kopshtit të fëmijëve mësojnë gjermanisht duke lozur dhe ku barazia e shanseve qëndron në qendër. Kjo gjë mbështetet me kontributet financiare nga ana e programit Kantonal të Nxitjes së hershme të gjuhës.

Personeli kujdestar me kënaqësi ju qëndron në dispozicion për pyetje në këtë proces, sepse mbi bazën e një marrëdhënieje plotë besim në bashkërisht mund të arrijmë më shumë për fëmijën tuaj!